



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

GJETJET KRYESORE TË ANKETËS MBI INSPEKTIMIN TATIMOR

Mbledhje e Këshillit të Investimeve, dt. 5 Tetor 2015

Përmbajtja e Prezantimit të Anketës

- ▶ I. Hyrje
- ▶ II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura
- ▶ III. Gjetjet mbi Efektivitetin e:
 - ▶ Proçesit të Kontrollit Tatimor
 - ▶ Apelimit Tatimor
 - ▶ Ndërgjegjësimin e Taksapaguesve
- ▶ VI. Përmbledhje e Komenteve të Bizneseve në Pyetësor



I. Hyrje

▶ **Objektivi i Anketës**

- ▶ Synon të identifikojë problemet kryesore në lidhje me procesin e kontrollit tatimor dhe të shërbejë si bazë për hartimin e rekomandimeve përkatëse.

▶ **Metoda**

- ▶ Anonime
- ▶ Hedhur online në Shqip dhe gjuhën Angleze në faqen e internetit të Këshillit dhe ndarë në Facebook nëpërmjet llogarisë së KI
- ▶ Shpërndarë nëpërmjet Shoqatave të Biznesit.

▶ **Periudha**

- ▶ 27 Gusht 2015 – 14 Shtator 2015




II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura

► 110 biznese

► 78% shqiptare dhe 22% me pronësi të huaj.

► 78% të mesme dhe të mëdha dhe 22% biznese të vogla

Sektorët përfaqësues në Anketë



► Ndarja e madhësisë së Biznesit është bërë në bazë të xhiros vjetore, mbi dhe nën 8 million lekë, sipas ligjit për Taksat Vendore.

III. Gjetjet mbi Efektivitetin e Proçesit të Kontrollit Tatimor


Përkufizimi Ligjor i Llojit të Kontrollit Tatimor

Në bazë të ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24, datë 02.09.2008 “Mbi Procedurat Tatimore”, një kontroll tatimor mund të jetë në formën e mëposhtme:

- ▶ Kontroll i plotë në vend
- ▶ Vizitë fiskale
- ▶ Verifikime në terren
- ▶ Rikontrolle



3.1 Lloji, Kohëzgjatja e Kontrollit të Fundit gjatë 2013-2015 për Biznesin e Madh




- 93% kanë qënë subjekt i një kontrolli të plotë për 2013-2015.

- Në 43% të bizneseve të mëdha kontrolli ka zgjatur nga 1 – 4 javë.


Sipërmarrjet e vogla kanë qënë kryesisht subjekt i Inspektimeve në terren (46%) dhe Vizitave Fiskale (42%). Megjithatë, vihet re se 38% e të anketuarve i janë nënshtruar gjithashtu një kontrolli të plotë.

3.2 Kapacitetet e Inspektorit Tatimor sipas madhësisë dhe pronësisë së biznesit


Biznesi i Madh



Biznesi i Vogël




Sipermarrësit e Huaj



- Nivele të ngjashme vlerësimi veçanërisht në lidhje me Etikën/ Komunikimin/Kompetencat.
- Për Biznesin e madh, problematikë e theksuar mbetet mbështetja logjistike e Inspektorit.
- Niveli shumë i lartë i pakënaqësisë është i dukshëm tek Sipërmarrësit e Huaj


3.2 Vlerësim mbi Kapacitetet e Inspektorit Tatimor sipas sektoreve

Shërbimet




➤ Në sektorin e Shërbimeve, ka vlerësimin më negativ nga të gjithë sektorët mbi **kapacitetet e inspektorëve**, veçanërisht për logjistikën që shoqëron inspektimin.

Hoteleri dhe Operatorë Turistik




➤ Në Hoteleri dhe Operatorë Turistikë, 65% e përgjigjeve janë nga Kompani të mëdha dhe kanë vlerësime disi jo pozitive për kapacitetet e inspektorit.

3.2 Vlerësim mbi Kapacitetet e Inspektorit Tatimor sipas sektorëve





- Në Industri, 88% e përgjigjeve nga Kompani të mëdha dhe 33% janë me pronësi të huaj. **Industria është sektori me vlerësimin më pozitiv mbi nivelin e profesionalizmit të Inspektorit Tatimor.**




- Në Tregti, 82% e përgjigjeve vijnë nga Kompani të mëdha dhe vihet re një nivel më i lartë pakënaqësie pas Sektorit të Shërbimeve mbi aftësitë e Inspektorit Tatimor.

3.3 Vlerësim mbi Qartësinë e Raportit të Kontrollit Tatimor sipas madhësisë së biznesit




Sipërmarresit e Huaj




- Përgjigje më të ekuilibruara kanë ardhur nga subjektet e mëdha, ndërkohë që raportohet “problematic” nga kompanitë e huaja. Më shumë qartësi kërkohet vecanërisht në referencat dhe gjetjet/përfundimet e raportit (siç mund të jetë rasti i gjobave).
- Bizneset e vogla kanë një qëndrim më pozitiv ndaj raportit të kontrollit, e lidhur edhe me natyrën e kontrolleve të kësaj kategorie, si verifikimet në terren dhe vizitat fiskale. Sidoqoftë, ka në përqindje të konsiderueshme pa përgjigjeve ndaj pyetjes duke lënë vend për interpretime mbi të kuptuarit e raportit.

3.3 Vlerësim mbi Qartësinë e Raportit të Kontrollit sipas sektorëve





Sektori i Shërbimeve paraqet **vlerësimin më negativ** ndër sektorë mbi qartësinë e raportit të kontrollit, në koherencë kjo edhe me komente për kapacitetin e inspektorit tatimor



Ndiqet nga Tregtia edhe pse në nivele më të ulëta, si sektorët më të pakënaqur.

3.3 Vlerësim mbi Qartësinë e Raportit të Kontrollit sipas Sektorëve




Sektorët me vlerësimin më pozitiv në lidhje me qartësinë e kontrollit dhe rezultatet e tij, në mënyrë të veçantë e dukshme tek Industria.


IV. Gjetjet mbi Efektivitetin e Apelimit Tatimor

Biznesi i Madh

A keni ndërmarrë gjatë 3 viteve
të fundit një proces apelimi
tatimor?



Efektiviteti i procedures




Biznesi i Madh ka apeluar më së shumti. Vërehet një nivel shumë i lartë pakënaqësie në lidhje me Proçedurat e Apelimit Tatimor.




V. Gjetjet mbi Ndërgjegjësimin e Taksapaguesve

5.1 Mendimi i Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mëdha mbi Zbatimin e Duhur të Legjislacionit Tatimor



- Kompanitë e mëdha mendojnë se zbatimi i duhur i legjislacionit lidhet më së shumti me qartësinë e legjislacionit dhe interpretimin e saktë të tij.
- Për Biznesin e vogël, zbatimi i duhur i legjislacionit ka të bëjë më tepër me informimin e duhur të tatimpaguesve.


5.1 Mendimi sipas Sektorëve mbi Zbatimin e Duhur të Legjislacionit Tatimor




- Qartësia e Legjislacionit dhe Interpretimet e tij janë më të rëndësishëm në sektorin e Industrisë, Tregtisë dhe Shërbimeve;
- Kapacitetet e Administratës vlerësohen se kanë rol më shumë nga Shërbimet dhe Hoteleri e Operatorë Turistikë;
- Informimi i duhur mbi legjislacionin është një aspekt i vlerësuar konsiderueshëm, sidomos në Hoteleri e Operatorë Turistik.

5.2 Trajnimi i Tatimpaguesve sipas Madhësisë së Bizneseve

Biznesi i Madh




Biznes i Vogel





Niveli i trajnimeve është relativisht i ulët, dhe sipas komenteve janë zhvilluar trajnime kryesisht për deklarimin online nga Janari 2015.

5.3 Vlerësim mbi Qartësinë e Shpjegimeve të Legjislacionit ofruar nga Administrata Tatimore sipas madhësisë biznesit dhe sektorit



Vlerësimi i përgjithshëm është për një paqartësi të shpjegimeve mbi legjislacionin tatimor të ofruar nga Administrata Tatimore. **Më problematike vlerësohet qartësia e shpjegimeve nga sektori i Sherbimeve dhe Biznesi i vogel.**


5.4 Vlerësim mbi Shërbimet Elektronike të Tatimeve



Vlerësimi është kryesisht pozitiv, me një nivel të konsiderueshëm kënaqësie sidomos për Biznesin e Madh.


5.5 Informimi i Tatimpaguesve mbi Zbatimin e Sistemit të ri të Riskut të Përzgjedhjes për Kontroll

Biznesi i Madh



■ Po ■ Jo

Biznesi i Vogël




■ Po ■ Jo

Nga përgjigjet e marra, ka disi dijeni paraprake në nivele të ngjashme si nga biznesi i madh dhe i vogël mbi zbatimin e përzgjedhjes sipas sistemit të ri të riskut.




5.6 Perceptim i Biznesit mbi Faktorët më të rëndësishëm që çojnë në Aktivitet Informal



- TVSH është faktori i parë më i rëndësishëm sipas përgjigjeve që mendon se con në aktivitet informal
- Legjislacioni Tatimor është vlerësuar si faktori i dytë më i rëndësishëm
- Marrëdhëniet me Administratën Tatimore si faktori i tretë më i rëndësishëm

5.6 Perceptim i Biznesit mbi Faktorin e Parë më të rëndësishëm që çon në Aktivitet Informal



- TVSH në shumicën e sektorëve dhe si për Biznesin e Madh dhe për Biznesin e vogël ngelet faktori i parë që çon në informalitet.
- Legjislacioni Tatimor është një faktor tjetër që konsiderohet i parë për sektorin e Shërbimeve
- Në Tregti është bërë i njëjti vlerësim nga kompanitë e përgjigjura si për TVSH dhe për Legjislacionin Tatimor

-
- ▶ Përmbledhje e Komenteve të mbërritura nëpërmjet Anketës në pyetjet e hapura sipas çështjeve në vijim.

Mbi Drejtorinë e Apelimit

- Të dëgjohet tatimpaguesi në takime te organizuara dhe jo të penalizohet;
- Proçedura e apelimit e zgjatur dhe e vonuar, formale;
- Nuk ka kuptim të hapet proçes gjyqësor brenda drejtorive për raste apelimi;
- Të jetë i qartë, miqësor dhe sqarues;
- Pagesa e detyrimit për ankimim është pengesë;
- Më shumë pavarësi të Drejtorisë së Apelimit;
- DAT duhet të jetë me profesional në argumentim;
- Të riorganizohet si një grup për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pjesëmarrjen e avokatëve, përfaqësues të biznesit, gjyqtarë.



Mbi Penalitetet Formale dhe jo Formale

- Kontrollët bëhen si fushatë, me tendencë për të gjendur diçka, gjopa e parashikuar
- Gjopa marramendëse të pabazuara në ligj, penalizohen më të rregullt
- Inspektorët jo kontabilistë
- Kërkesa absurde në kontroll për të vënë gjobë
- **Kërkohen procedura të veçanta kontrolli për baret, restorantet dhe hotelet.**
- Kontrollët tatimore kanë për bazë planin
- Nuk ka vullnet dhe strukturë që të kontrollojë punën e inspektorëve
- Me sistemin e ri kanë dalë gjopa për biznese që nuk janë rregjistruar për atë tatim.



Mbi Penalitete Formale dhe jo Formale

- Sa më të larta gjobat nga ligji, më kompleks ligji është dhe më shumë fuqi negociuese inspektorët për përfitime personale
- Ligjet duhet të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme
- Gjobat zyrtare bazohen në interpretime të ndryshme dhe jo profesionale të inspektorit nga kompania
- Mungesë konsistence në gjykimet e administratës
- Gjobat vendosur në masën maksimale edhe pse ka hapësirë për masa më lehtësuese.



Sugjerime për Minimizimin e Praktikave Korruptive

- Auditimet të kryhen nga kompanitë e mëdha të kontraktuara, jo nga tatimet;
- Inspektorët të ndershëm, profesional dhe të specializuar;
- Reduktim të kontaktit me inspektorët;
- Subjektet të konsiderohen si partnerë dhe jo për t'i zhvatur;
- Kontrolli tatimor të jetë i mbikqyrur nga kamera;
- Sa më pak partiakë të punësuar, penalizim i inspektorëve të korruptuar;
- Akti i kontrollit të ketë një fletë ankete për sjelljen dhe aftësinë profesionale të inspektorëve;
- Rivlerësim të raporteve të kontrollit.



Sugjerime për minimizimin e praktikave korruptive

- Proçedurat tatimore duhet të jenë të qarta. Jo inspektive jashtë orarit të punës
- Më shumë komunikim, më shumë transparencë me biznesin në përcaktimin e riskut
- Informatizim, formalizim dhe vënia e drejtuesve të ndershëm, profesionalizëm, integritet
- Motivim i inspektorëve, trajtim më i mirë financiar
- Të vlerësohen bizneset që janë të rregullta
- Kontrole të targetuara me nivel të lartë risku që do bëjë të mundur përdorim më të mirë të burimeve
- Thjeshtim i proçedurave në përputhje me taksat
- Legjislacion i qartë i taksave, të shmangë dykuptimet, i publikuar dhe i shoqëruar me praktika zbatimi



Mbi Rolin dhe Mbështetjen e Zyrës së Avokatit të Tatimpaguesit

- Formal
- Të jetë i pavarur
- Shumë i rëndësishëm
- Rol tek rritja e transparencës dhe komunikimit për përmirësimin e klimës së besimit.
- Nuk ka dijeni mbi ekzistencën e Avokatit
- I Ulët
- Nuk ka rol aktiv, më pranë tatimpaguesve
- Të dëgjohet mendimi i Avokatit kur hartohen ligjet ose për çështjet në gjykatë



Burimet e Informacionit mbi Legjislacionin Tatimor

- Intepretimet jo të qarta
- Drejtoria Teknike pranë DPT shpesh herë nuk kthen përgjigje kërkesave për interpretim. Edhe kur kthen jep referenca ligjore dhe jo interpretim të ligjit
- Ndryshimet ligjore t'i dërgohen biznesit për dijeni nëpërmjet e-mailit
- Informacioni merret nga faqja e tatimeve në internet dhe ekspertët kontabël
- Informacioni merret nga Qendra e Publikimeve zyrtare, përditësimi i faqes së tatimeve bëhet me vonesë
- Faqja e Tatimeve duhet të përmbajë të gjitha interpretimet e bëra për raste të caktuara që të jenë të zbatueshme nga tatimpaguesit.



Çështje të tjera

- T'i lihet kohë biznesit të formalizohet
- Të hiqen çmimet e referencës, të njihen faturat e mallrave të importit nga BE, dhe faturat e transportit
- Njohja e TVSH për bizneset e vogla
- Përshpejtim i procedurave të falimentit
- Informatizim në maksimum dhe uljen e mundësisë së kontrolleve me paramendim
- Ka papërgjegjshmëri në marrëdhëniet me biznesin
- Njerëz të pakualifikuar
- Heqja e klasifikimit të bizneseve në bazë të xhiros
- Thjeshtësoni ligjet, trajtoni inspektorët, ndiqni informalitetin dhe bizneset e paregjistruar, shpërblim për tatimpaguesit e ndershëm.

